



KOMPANIA REGJIONALE PËR MBETURINA
REGIONALNA KOMPANIJA ZA OTPADKE
"EKOREGJIONI" SH. A. –D.D. PRIZREN

Email:krm_ecoregjioni@yahoo.com

Prizren, 14.01.2021

Kompania Regjionale për Mbeturina "Ekoregjioni" SH.A. me seli në Prizren, konform vendimit të Bordit, dt.14.01.2021,
SHPALLË këtë:

KONKURS

Për 8 vende të lira pune (me kontratë në kohë të caktuar/mvarësisht nga kontrata me KK Rahovec)

Vendi i punës : Suharekë/Njesia Operative Suharekë

Titulli i vendit të punës:

- a)3(tre) inkasant
- b)2(dy) vozitës kat-C.
- c) 4(katër)Punëtor fizik

Detyrat dhe përgjegjësitë:

a)Inkasant

a)Te jete i/e afte qe me orar te plote dhe pa kufizime te kryej detyrat sipas kontrates se punes, - Bënë inkasimin e mjeteve në bazë të faturave me të cilat ngarkohet materijalisht, -bën zbulimin-regjistrimin me kohë të sipërfaqeve të reja dhe të paregjistruara dhe përcjell ndryshimet apo ndërrimet e sipërfaqeve dhe ndryshimet tjera të nevojshme në sektorin e amvisëris respektivisht komercial duke e nojftuar Shërbimin e faturimit.(pergjegjesin) - Të gjitha paratë e inkasuara i dorëzon brenda dite, në bankën më të afërt apo sipas nevojës , në arkën kryesore të kompanisë, -kryen edhe punë të tjera të përcaktuara nga punëdhënësi sipas nevojës të procesit të punës në interes të ndërmarrjes

b)vozites C

1)Sipas Urdhëresës së Punës drejton automjetin dhe kujdeset për rregullësin, higjienën dhe pastërtin e tij2) Është përgjegjës për vozitje të sigurt dhe për kryerjen me kohë, efikase dhe kualitative të shërbimeve në bartjen e mbeturinave, larjen e rrugëve etj.3)Në rastet kur e kryen terenin e caktuar angazhohet në pika (zona),tjera sipas urdhëresës së udhëheqësit-kryepunëtorit,4)Para daljes në teren merr Urdhëresën e Punës në të cilën evidencon punët e kryera , vërejtjet mbi pengesat dhe defektet në automjet, dhe të njejtën e kthen te dispeçeri,5) Vendos (monton) letren e re të tahogرافit ndërsa letren paraprake e kthen te dispeçeri, brenda 12 orëve,6) Vozitësi i cili e monton letren e tahogرافit ka obligim që në te të shenon:Emrin e tij, numrin e regjistrimit të automjetit, datën dhe kilometrazhën fillestare dhe përfundimtare,7) Është i obliguar që në automjet të ketë mjetet e nevojshme të punës (lopatat, fshisat etj.), për ekipën e punëtorëve me të cilët punon,largon(bartë) shtazët e ngordhura dhe i evidenton në urdhëresën e punës8) Në rast nevojë ndrron gomat e automjetit në teren, apo në punëtorinë e mirëmbajtjes në bashkëpunim me gomisterin,9) Është i obliguar që prishjet në automjet me kohë t'i lajmron me shkrim te udhëheqësi i drejtpërdrejt dhe në punëtorinë e mirëmbajtjes10) çdo sjellje të pandërgjegjëshme apo mungesë nga procesi i punës, të punëtorëve me të cilët punon, vozitësi është i obliguar ta paraqet te udhëheqësi i drejtpërdrejt-kryepunëtorit. brenda orarit të punës,11) E njofton kryepunëtorin për kontejnerët e dëmtuar dhe sipas kërkesës së tij, bënë bartjen e tyre në punëtorinë e mirëmbajtjes për riparim,12)është i obliguar që në Deponi të mbeturinave tu përmbahet rregullave dhe

obligimeve të parapara në lidhje me procesin e punës në Deponi,13)Është i obliguar që çdo here pas kthimit në autopark të paraqitet te dhënësi i karburanteve për mbushje të rezervuarit me naftë,14)Nëse automjeti me të cilin punon ndodhet në prishje apo jasht planit momental për përdorim, është i obliguar që të drejton automjet tjetër , dhe të kryen punë tjera sipas urdhëresës së udhëhqësit, nevojës së procesit të punës dhe interesit të ndërmarrjes.

c)punëtor fizik

- -Te jete i/e afte qe me orar te plote dhe pa kufizime te kryej detyrat e punes sipas kontrates se punes,
- -Udheheq sherbimet e riparimeve, riparon , kontrollon kushtet ne teresi te çeshtjet mekanike dhe elektrike,
- Kryen të gjitha punët fizike ne mbledhjen dhe ngarkimin e mbeturinave,
- -zbrazen e kontejnerëve dhe pastrimin e lokacionit rreth tyre, sipas planit operativ dhe urdhënesës se punës,
-bën fshirjen-pastrimin dhe larjen e rrugëve, apo pastrimin e rrugës dhe trotuarve nga bora dhe akulli, hudhjen e kripës,
- -Bën largimin e qenëve dhe macave të ngordhura dhe vendosjen e tyre në kontejner.
- -Është i obliguar që të ketë sjellje korrekte ndaj qytetarëve dhe shfrytëzuesve të sherbimeve. -Është përgjegjës për përdorim të kujdesshëm të kontejnerëve dhe mjeteve të punës,
- -mvarësisht nga natyra dhe sektori, bën hapjen e varreve dhe mirmbajtjen e tyre konform urdherave te marra,
- - kryen punë tjera sipas urdhëresës së udhëhqësit, nevojës së procesit të punës dhe interesit të ndërmarrjes.

I punësuari punësohet për punë me orar të plotë të punës, i cili është 40 orë në javë, me kontratë pune(provuese/në kohë të caktuar dhe mvarësisht nga performanca e te punsuarit dhe nevoja e kompanise te njejteve i rregullohet mardhenja e punës)

Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për aplikuesit janë:

- Përvoja e punës dhe shkollimi kan përparësi,
- patent shofer, Kat C e domosdoshme ne poziten, a.
- të jetë me gjendje shëndetësore të mirë.
- Ndaj të njëjtit të mos jetë duke u zhvilluar ndonjë procedurë penale,

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Kopja e letërnjoftimit,
- Kopje e patent shoferit me afat të vlefshëm(e domosdoshme per vozitesin-C)
- Kopja e certifikates se lindjes,
- Certifikatën shëndetësore sillet (pas konfirmimit te pranimit ne punë)
- Certifikata për të kaluarën kriminale nga Gjykata
- Kopje e diplomës , certifikata të shkollës mesme, fillore etj.(qfar posedon aplikuesi).
- Dëshmi për përvojën e punës (trust etj/ nese posedon)
- Zarfi me poziten konkruuese dhe me numrin e telefonit /email adresë(për kontakt).

Konkursi mbetet i hapur 8 ditë nga dita e shpalljes në webfaqen e kompanisë.

Dokumentacioni i kërkuar dorëzohet me zarf të mbyllur në protokolin e Kompanisë, (shënohet emri/mbiemri/ pozita ne te cilen konkurron, nr.telefonit dhe email adresa) në, adresën KRM "Ekoregjioni" SH.A. Rr. Kukës nr. 10 në Prizren- **kopjet e dorzuara nuk kthehen.Kandidatët të cilët i plotësojn kriteret, do të njoftohen me telefon/email për vendin dhe kohën e testit/ intervistës.**